




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 01.10.2025 DERI MË 10.10.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6598-2025
2.	Vendim për lejin e pagesës për punë jashtë orarit të punës.	NRP-02-6599-2025
3.	Vendim për lejin e pagesës për punë jashtë orarit të punës.	NRP-02-6600-2025
4.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve.	NRP-02-6601-2025
5.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6604-2025
6.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve për rinovim dhe mirëmbajtjen e Muzeut Etnologjik "Anadrinia".	NRP-02-6607-2025
7.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Furnizimi me material higjieniko-sanitar për shkollat e komunës së Rahovecit-Ritenderim".	NRP-02-6609-2025
8.	Vendimi për përfshirjen në listën e pagave me pagë të plotë mujore.	NRP-02-6613-2025
9.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-6616-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA KOTOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No <u>02</u> (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>6598</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>162</u>
Data/Datum/Date <u>01 / 10 / 25</u>
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Arta Vuçitërna nga Rahoveci me Nr. Prot. 3259 të datës 24.9.2025, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Arta Vuçitërna nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Mësimdhënëse e programit fillor në SHFMU "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm, nga data 1.10.2025 deri me date 30.9.2026.
2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet Zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largoj nga lista e pagës të lartpërmendurën për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Arta Vuçitërna nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Mësimdhënëse e programit fillor në SHFMU "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 3259 të datës 24.9.2025, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 1.10.2025 deri me date 30.9.2026.

Kërkesën për pushim nga puna pa pagesë e lartpërmendura e ka parashtruar për shkak të rrethanave familjare, respektivisht për kujdesja ndaj familjes.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6599 Nr. i faq./Br.str./No.pg 162

Data/Datum/Date 01 / 10 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nënpunësve civil Nr.03/L-147 të datës 13.05.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet tjera të Nënpunësve civil, neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për **Selami Shterbani** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec, Drejtoria për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë **jashtë orarit të punës** është **30 (tridhjetë euro)** për kryerjen e punës respektivisht kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës së Rahovecit** i cili me datë **02.08.2025** në ceremoninë e martesës ka kryer lidhjen e kurorëzimit të qiftit **Besart Morina** dhe **Benita Borovci**, ceremonia është zhvilluar në restaurantin Dukagjini (Radoniqi) me fillim në ora 19.00 h.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi Pagat dhe Meditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me kërkesën e **Selami Shterbani** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit dhe me autorizimin e Drejtorit për Administratë të datës **01.08.2025** punëtori i lartcekur ka marrë pjesë me **02.08.2025** në kurorëzimin të shtetasve të Republikës së Kosovës jashtë objektit të Komunës së Rahovecit, prandaj për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës së Rahovecit** dhe **jashtë orarit të punës** duke u bazuar në legjislacionit në fuqi është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me Vendim të njoftohen :

- **Selami Shterbani** , Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**
- **Zyrës së Personelit , dhe**
- **Arkivi**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6600 Nr. i faq./Br.sht./No.pg. 162

Data/Datum/Date 01/10/25

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nënpunësve civil Nr.03/L-147 të datës 13.05.2010 dhe nenit 11 të Rrregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet tjera të Nënpunësve civil, neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për **Selami Shterbani** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec, Drejtoria për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë **jashtë orarit të punës** është **30 (tridhjetë euro)** për kryerjen e punës respektivisht kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës së Rahovecit** i cili me datën **08.08.2025** në ceremoninë e martesës ka kryer lidhjen e kurorëzimit të qiftit **Drilon Hoti dhe Sala Kermen**, ceremonia është zhvilluar në Krushë të Madhe (Shtëpia e Drilon Hotit) me fillim në ora 14h.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi Pagat dhe Meditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me kërkesën e **Selami Shterbani** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit dhe me Autorizimin e Drejtorit për Administratë të datës **07.08.2025** punëtori i lartcekur ka marrë pjesë me **08.08.2025** në kurorëzimin të shtetasve të Republikës së Kosovës jashtë objektit të Komunës së Rahovecit, prandaj për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës së Rahovecit dhe jashtë orarit të punës** duke u bazuar në legjislacionit në fuqi është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me Vendim të njoftohen :

- **Selami Shterbani**, Zyrtar i gjendjes civile në Rahovec
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**
- **Zyrës së Personelit**, dhe
- **Arkivi**



Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6601 Nr. i faq/Br.str/No.pg 163
Data/Datum/Date 01 / 10 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1 pika 1.5 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017 dhe kërkesës së Driton Krasniqi nga fsh. Hoçë e Vogël Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolit 3190 të dt. 18.9.2025, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga fsh. Hoçë e Vogël Komuna e Rahovecit për mbulimin e shpenzimeve të transportit (udhëtimit) të djalit me nevoja te veçanta, i cili është i regjistruar në shkollën speciale Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi" në Prizren.
2. Mbulimi i shpenzimeve të transportit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet për 4 (katër) muaj, nga data 1.9.2025 deri me datë 31.12.2025 dhe atë 210€ (dyqind e dhjetë euro) në muaj.
3. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 3190 të datës 18.9.2025 me anë të së cilës ka kërkuar mbulimin e shpenzimeve të transportit (udhëtimit), pasi që është duke e dërguar djalin e tij me nevoja të veçanta në shkollën speciale Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Lef Nosi" në Prizren.

Duke marrë parasysh se i lartpërmenduri është duke udhëtuar me transport privat për dërgimin dhe marrjen e djalit në këtë shkollë speciale në Prizren ka kosto të lartë financiare, është e domosdoshme ndihma për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi


Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga fsh. Hoçë e Vogël,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Leonora Koçinaj nga Prizreni me Nr. Prot. 3256 të datës 24.9.2025, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit pa pagesë nga puna

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Leonora Koçinajt nga Prizreni, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Mirëqenie Sociale në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nga data 3.11.2025 deri më datë 30.10.2026.
2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës të lartpërmendurën për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Leonora Koçinaj nga Prizreni, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Mirëqenie Sociale në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 3256 të datës 24.9.2025, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 3.11.2025 deri më datë 30.10.2026.

Kërkesën për pushim nga puna pa pagesë, e lartpërmendura e ka parashtruar për arsye shëndetësore, respektivisht gjendjes së rëndë shëndetësore të anëtarit të ngushtë të familjes, i cili kërkon mbikëqyrje të rregullt.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Leonora Koçinaj nga Prizreni,*
- *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrtari/ja për paga,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6607 Nr. i faq./Br.str./No.pg 163
Data/Datum/Date 06 / 10 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Muzeut Etnologjik “Anadrinia”** në Drenoc, me **nr. protokolli 3307** të datës **1.10.2025**, për ndihmë financiare prej **700.00€** (shtatëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve për rinovimin dhe mirëmbajtjen e muzeut.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Shoqata e Muzeut “Anadrinia” në Drenoc, ka parashtruar kërkesë më datë 1.10.2025, me numër të protokollit 3307, për përkrahje me mjete financiare për mbështetjen për nevojat e Muzeut Etnologjik “Anadrinia” në Drenoc.

Andaj, duke marrë parasysh nevojën e ndihmës financiare me qëllim të mirëmbajtjes dhe të rinovimit të këtij muzeu, është e domosdoshme ndihma financiare.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- **Muzeu Etnologjik “Anadrinia”** në Drenoc,
- **Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6609 Nr. i faq./Br.str./No.pg 163

Data/Datum/Date 7 / 10 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizimi me material higjieniko – sanitar për shkollat e komunës së Rahovecit – ritenderim"**, me numër të kontratës: **623-25-4730-1-2-1/C697**, si në vijim:
 - 1.1. Qamil Sylka, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Depoist në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Admirim Durguti, zyrtar për paga dhe shpenzime, në Drejtorinë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e menaxherit të projektit/kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë që operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e menaxherit të projektit/kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, menaxheri i kontratës

- brenda afatit, duhet të krijojë planin për menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë planin e menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me operatorin ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë planin e aprovuar të menaxhimit të kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që autoriteti kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë që ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**


Smajl Latif
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6613 Nr. i faq/Br.str/No.pg 164

Data/Datum/Date 09 / 10 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë :

V E N D I M

1.**OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që znj. **Saranda Rama**, e sistemuar në punët dhe detyrat e punës Zyrtar për Çështje Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Rahovecit, të përfshihet në listat e pagave me pagë të plotë mujore, duke filluar nga data 09.10.2025.

2.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimit iu dorëzohet:

1. Saranda Rama
2. Drejtorisë për Financa dhe Buxhet
3. Njësia e Përsone lit
4. Arkiva.

Kryetari i komunës

Smajl Latifi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**

KOMUNA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6616 Nr. i faq./Br.str./No.pg 164
Data/Datum/Date 10 / 10 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [REDACTED] nga Celina, me nr. prot. 3359, të datës 8.10.2025, për ndihmë financiare prej 350.00€ (treqind e pesëdhjetë euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe për blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. [REDACTED] uan nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe është i papërballueshëm për të.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së tij, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Z. [REDACTED] nga Celina,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

